



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Shkurt 2022

Nr: 104

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË AMBASADËS HOLLANDEZE, ITALIANE, GREKE,
ÇEKE, DHE AUSTRIAKE, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR
KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 25.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

KËRKUES:

1. Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, me seli në Tiranë, Rruga “Asim Zeneli” dhe përfaqësues z. Reinout Vos;
2. Ambasada e Italisë, me seli në Tiranë, Rruga “Papa Gjon Pali” dhe përfaqësues z Fabrizio Bucci;
3. Ambasada e Greqisë, me seli në Tiranë, Rruga “Skenderbeg” dhe përfaqësuese zj. Sophia Philippidou;
4. Ambasada e Çekisë, me seli në Tiranë, Rruga “Skënderbej” dhe përfaqësues z. Karel Urban;
5. Ambasada e Austrisë, me seli në Tiranë, Rruga “Xibrakët” dhe përfaqësues z. Christian Steiner.

OBJEKTI:

Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatshkurtër dhe afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE:

Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullate vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,



VËREN:

Ambasada e Hollandës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Mbretërisë së Hollandës është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Italisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 5 (pesë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Italisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Greqisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Greqisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Çekisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Çekisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Austrisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 6 (gjashtë) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Austrisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008,“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve të Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 5 (pesë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyesve të Ambasadës së Italisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi
3. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve Ambasadës së Greqisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve të Ambasadës së Çekisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 6 (gjashtë) përkthyesve të Ambasadës së Austrisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 5 që i bashkëlidhet këtij vendimi.



6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

